

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik pranë Institutit të Gjeoshkencave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik “Lektor” në Departamentin e Hidrologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

I. Formimi akademik:

1. Të ketë diplomë Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Gjeografisë dhe Gjeo-informatikës;
2. Preferohen kandidatët që kanë diplomë Master i Shkencave në “Remote Sensing”;
3. Të ketë notë mesatare (Bachelor+Master i Shkencave) mbi 8.00;
4. Të ketë doktoraturë në fushat e mësipërme.

II. Aftësi teknike dhe eksperiencë:

Kriteret e punësimit janë si më poshtë:

1. Të ketë njohuri të mira në sistemet/software GIS si ArcGIS, ILWIS, MapInfo, MicroStation, Global Mapper, ENVI, ERDAS dhe Python, për përpunimin e të dhënave (prurjet e ujit etj).
2. Zhvillime të aplikacioneve dhe shërbime inovative për të mbështetur pr ojektet të fokusuara në rreziqet natyrore (përmytjet, thatësira, zjarret etj) dhe gjeologjike (rrëshqitjet).
3. Të ketë aftësi për të siguruar të dhëna me cilësi të lartë nga imazhet satelitore për vlerësimin e rreziqet natyrore (përmytjet, thatësira, zjarret etj) dhe gjeologjike (rrëshqitjet) për një territor të caktuar, zhvillimi i një metodologjie efektive për të parashikuar me saktësi të lartë rreziqet natyrore, ndërtimi i një sistemi operacional në kohë reale për të mbështetur vendimmarrjen qendrore dhe lokale me informacionin që i nevojitet.
4. Të ketë aftësi dhe eksperiencë teknike në integrimin dhe përpunimin e të dhënave të siguruar nga burime të ndryshme, të cilat mundësojnë investigimin e kushteve mjedisore në shkallë të ndryshme hapësinore dhe kohore (upscaling dhe downscaling) duke shfrytëzuar teknologjitë e GIS, proksimal/remote sensing, modelimit dhe Machine Learning (ML).
5. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse, së paku niveli B2, përbën avantazh njohja e gjuhës angleze në nivelin C1.
6. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **14.03.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.